



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

Kryesues i KD-së
Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 690 Dt 18.03.2022

Në bazë të nenit 24, pika 1.4, të Statutit të Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 04.02.2022, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet draft- Rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Zhvillim Profesional dhe Edukim.
- II. Pjesë e këtij vendimi është edhe Rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Zhvillim Profesional dhe Edukim.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Fakulteteve.
3. Zyrës për komunikim me publikun



Kryesuesi Këshillit Drejtues
Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së

Prof. asoc. dr. techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 691 Dt 18.03.2022

Në bazë të nenit 24, pika 1.4, të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini", Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 04.02.2022, miratoi:

RREGULLOREN MBI

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR
ZHVILLIM PROFESIONAL DHE EDUKIM**

Neni 1

Emërtimi

1. Qendra do të quhet: "Qendra për Zhvillim Profesional dhe Edukim".
2. Shkurtesa e Qendrës do të jetë: "CPDE" (*Center for Professional Development and Education*).
3. Qendra është pjesë e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM).

Neni 2

Qëllimi e Qendrës

Qendra për Zhvillim Profesional dhe Edukim (CPDE) ka për qëllim të ndihmojë Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, për avancimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore të cilat promovojnë mësimdhënien më efektive dhe më cilësore, në funksion të transformimit të UIBM-së në një universitet konkurrent me universitetet më të mira në Rajon dhe Evropë.

Neni 3

Aktivitetet e Qendrës

1. Për të realizuar qëllimet e tij të përcaktuara në nenin 2 të kësaj rregullore, CPDE do të kryej, por pa u kufizuar në aktivitetet si në vijim:
 - 1.1. Zhvillimin dhe realizimin e trajnimeve që do të plotësojnë nevojat e stafit akademik në UIBM dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë;
 - 1.2. Zhvillimin dhe realizimin e trajnimeve që do të plotësojnë nevojat e stafit të institucioneve parashkollore, në arsimin fillor dhe të mesëm.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- 1.3. Organizimin e certifikimeve të ndryshme për stafin akademik dhe grupet tjera të interesit;
- 1.4. Identifikimin dhe prioritizimin e sfidave, nevojave dhe mundësive që UIBM t'i adresojë nëpërmjet trajnimeve dhe programeve të ofruara në CPDE;
- 1.5. Botimin e hulumtimeve dhe studimeve të tjera që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- 1.6. Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe institucioneve tjera vendore dhe ndërkombëtare që kanë për fokus procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- 1.7. Identifikimin dhe zhvillimin e formave alternative të mbështetjes financiare për CPDE dhe inkurajimi i donatorëve për të investuar në përmirësimin e mësimdhënies në UIBM.

Neni 4

Organet Drejtuese të Qendrës

1. Qendra ka këto organe drejtuese:
 - 1.1. Bordi i Qendrës;
 - 1.2. Drejtori i Qendrës;
 - 1.3. Sekretari i Qendrës.

Neni 5

Bordi i Qendrës

1. Bordi i Qendrës ka pesë (5) anëtarë, si në vijim:
 - 1.1. Dy anëtarë nga stafi akademik (të propozuar nga rektori nga radhët e të cilëve zgjidhet kryesuesi i Bordit);
 - 1.2. Prorektori për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë (anëtar sipas detyrës zyrtare);
 - 1.3. Një anëtar nga stafi akademik i universiteteve tjera publike në Kosovë (i propozuar nga rektori);
 - 1.4. Një anëtar nga shoqëria civile (i propozuar nga rektori dhe me përvojë të dëshmuar në aktivitete në fushën e arsimit).
 - 1.5. Lista e anëtarëve të Bordit të propozuar nga rektori miratohet në Këshillin Drejtues.
2. Drejtori dhe Sekretari janë anëtarë të Bordit pa të drejtë vote.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

3. Anëtarë të Bordit të Qendrës nuk mund të jenë:

3.1. Personeli akademik që kanë ndonjë pozitë udhëheqëse në UIBM (anëtar i KD-së, rektor, prorektor, dekan, prodekan, shef departamenti, koordinator për cilësi e të ngjashme) me përjashtim nga rasti i përcaktuar më sipër nga neni 5 (1.2);

3.2. Personeli akademik që kanë të shqiptuar masë disiplinore në dy vitet e fundit.

Neni 6

Mandati i Anëtarëve të Bordit

1. Anëtarët e Bordit kanë mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat (jo më shumë se 2 mandate gjithsej).
2. Bordi zgjedh kryesuesin nga radhët e stafit akademik, konform nenit 5, parag.1. pika 1.1
3. Kryesuesi thërret dhe udhëheq mbledhjet e Bordit.
4. Vendimet e Bordit merren me shumicë të votave nga të gjithë anëtarët e Bordit.
5. Bordi i Qendrës raporton në Këshillin Drejtues dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues.

Neni 7

Drejtori i Qendrës

1. Drejtori i Qendrës propozohet nga rektori i Universiteti dhe miratohet nga ana e Bordit të Qendrës. Drejtori ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes (jo më shumë se 2 mandate gjithsej) vetëm edhe për një mandat.
2. Drejtori duhet të zgjidhet nga radhët e stafit akademik, i cili duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt të punës në UIBM.
3. Qendra udhëhiqet nga drejtori i cili është zyrtari kryesor menaxhues.
4. Drejtori i Qendrës ka për detyrë të punoj në përmbushjen e të gjitha qëllimeve dhe aktiviteteve që dalin nga kjo rregullore.
5. Për punën e tij, drejtori i Qendrës i përgjigjet Bordit të Qendrës.

Neni 8

Sekretari i Qendrës

1. Sekretari i Qendrës propozohet nga drejtori i Qendrës dhe miratohet nga Bordi i Qendrës. Sekretari i Qendrës ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.
2. Sekretari duhet të emërohet nga radhët e stafit akademik të UIBM.
3. Sekretari ndihmon drejtorin dhe Bordin për të përmbushur qëllimet dhe aktivitetet që dalin nga kjo rregullore.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

4. Për punën e tij, sekretari i Qendrës i përgjigjet drejtorit të Qendrës dhe sipas kërkesës edhe Bordit të Qendrës
5. Qendra mund të ketë edhe të punësuar tjerë.

Neni 9

Shkarkimi i Bordit, drejtorit dhe sekretarit të Qendrës

1. Inicimin e shkarkimit mund ta bëjë:
 - a. Rektori;
 - b. Senati;
 - c. Këshillit Drejtues.
2. Shkarkimi i strukturave menaxhuese të Qendrës (Bordit, drejtorit dhe sekretarit të Qendrës) mund të bëhet nga Këshilli Drejtues i Universitetit me shumicë votash.

Neni 10

Trajnerët e Qendrës

1. Organet e Qendrës do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për caktimin e trajnerëve që do të realizojnë trajnimet e ofruara nga Qendra.
2. Trajnerët, të cilët janë pjesë e stafit të rregullt akademik të UIBM, përzgjidhen nga Bordi i Qendrës, pas propozimit të drejtorit të Qendrës, duke përfshirë trajnues nga të gjitha njësitë akademike të UIBM-së.
3. Trajnerët, të cilët nuk janë pjesë e stafit të rregullt akademik të UIBM, përzgjidhen nga një komision i emëruar nga Bordi i Qendrës, pas një konkursi publik.
4. Trajnerët, të cilët nuk janë pjesë e stafit të rregullt akademik të UIBM, mund të angazhohen pa konkurs nga drejtori i Qendrës, nëse janë pjesë e projekteve të fituara ose Organizatave Donatore.

Neni 11

Burimet e Financimit

1. Aktivitetet e Qendrës mund të financohen nga burime në vijim:
 - 1.1. Fondet e Universitetit dhe burimet tjera publike;
 - 1.2. Fondet e projekteve nacionale dhe ndërkombëtare;
 - 1.3. Nga aktivitetet vetanake;
 - 1.4. Nga donacionet;



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

1.5. Nga burimet tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Raporti dhe Plani i punës

1. Në fillim të çdo viti kalendarik, drejtori i Qendrës dorëzon raportin vjetor të punës për vitin e përfunduar dhe planin vjetor të punës për vitin në vijim.
2. Bordi i Qendrës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të punës për vitin e përfunduar dhe planin vjetor të punës për vitin në vijim.
3. Plani dhe raporti i punës, të miratuara sipas paragrafit 2, procedohen për miratim në Këshillin Drejtues.
4. Këshilli Drejtues ruan të drejtën për të kërkuar informata shtesë dhe mund të bëjë rekomandime të ndryshme që lidhen me zhvillimin dhe performacën e punës së Qendrës.
5. Realizimi i pagesave të Qendrës zhvillohet nga Zyra për Buxhet dhe Financa e Universitetit, konform procedurave, sikurse për pagesat tjera të Universitetit.

Neni 13

Lidhja e kontratave të punës

1. Çdo kontratë që lidh Qendra nënshkruhet nga rektori, pas propozimit nga drejtori i Qendrës.
2. Kontratat që lidh Qendra duhet të përmbajë:
 - 2.1. Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur;
 - 2.2. Përcaktimin e saktë të punëve dhe detyrave të punës;
 - 2.3. Vlerën e saktë të punëve të kontraktuara për secilin pozicion dhe punë.
 - 2.4. Vlerën e tërësishme të punës;
 - 2.5. Afatin e kryerjes së punëve dhe;
 - 2.6. Mënyrën e pagesës dhe afatin e ekzekutimit të pagesës;
3. Në projektet dhe aktivitetet e saj, Qendra mund të angazhojë edhe ekspertë jashtë UIBM-së.

Neni 14

Kompensimi dhe Pagesat

1. Drejtori dhe sekretari gëzojnë të drejtën për kompensim konform Rregullores për të ardhura personale në fuqi.
2. Pagesa për punët e kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse të Universitetit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

3. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punëve të kryera sipas projektit, respektivisht kontratës, sipas nenit 7, dhe pas pagesës të TVSH – së, bëhet si vijon:
- | | |
|-------------------------------|-----|
| a. Shpenzimet direkte | 20% |
| b. Rektoratin e Universitetit | 10% |
| c. Fakultetin përkatës | 10% |
| d. Personelin e angazhuar | 60% |
4. Drejtori dhe sekretari i Qendrës hartojnë raportin për ndarjen e mjeteve financiare dhe ia dërgojnë shërbimit financiar dhe prorektorit për financa, i cili jep urdhëresën për pagesën e mjeteve sipas raportit.

Neni 15

Dispozita kalimtare

1. Me qëllim të funksionalizimit të CPDE-së, brenda 15 ditëve, nga miratimi i kësaj rregulloreje, rektori do të propozojë anëtarët e Bordit të Qendrës në mbledhjen e Këshillit Drejtues.
2. Bordi i Qendrës, 7 ditë pas emërimit nga Këshilli Drejtues i UIBM, duhet të shqyrtojë dhe miratojë propozimet e rektorit për drejtor të Qendrës.
3. Drejtori i Qendrës, brenda 4 muajve, do të përgatisë planin e punës dhe aktet e tjera juridike të nevojshme për fillimin e aktivitetit dhe funksionalizimin e Qendrës, duke përfshirë edhe përzgjedhjen e trajnuesve të Qendrës, të cilat do të miratohen nga Bordi i Qendrës.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i UIMB-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja